# KREU 1

# DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

## Neni 1
## Objekti i Rregullores

Rregullorja e studimeve "Master i Shkencave" në programet e studimit "Drejtësi", profile *E drejtë ndërkombëtare* dhe profile *E drejtë penale* përcakton parimet e funksionimit të këtij programi.

## Neni 2
## Baza Ligjore

Rregullorja e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë - BEDER" mbështetet në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 10307, datë 22.07.2010 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, "Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë – BEDER", në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 03.04.2008 "Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë", në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 15, datë 04.04.2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë" si dhe në Statutin dhe Rregulloren Themelore të këtij institucioni.

.

# KREU 2
# PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

## Neni 3
## Objektivat formues specifikë të programit

Programi *Master i Shkencave në Drejtësi, Profili e Drejtë Penale* dhe *Profili e Drejtë Ndërkombëtare* është projektuar t'u ofrojë një horizont intelektual dhe profesional studentëve duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e shkencave juridike. Programi Master i Shkencave në Drejtësi synon tu ofrojë mundësi studentëve të thellojnë njohuritë dhe të specializohen në fushën e së drejtës kryesisht në fushën e së drejtës penale dhe ndërkombëtare duke u njohur me nocionet juridike penale dhe ndërkombëtare. Gjatë këtyre dy viteve studentët do të thellojnë njohuritë e marra gjatë ciklit të mëparshëm duke synuar përgatitjen e juristëve të kualifikuar për të punuar në organet e drejtësisë. Programi synon të

nxisë studentët të thellohen në punën kërkimore, shkencore dhe angazhimin e tyre si staf akademik

*Objektivat e Programit: Master i shkencave ne Drejtësi , profili e drejtë ndërkombëtare*

- Përvetësimi i koncepteve bazë juridike ndërkombëtare dhe përdorimi i tyre me efikasitet
- Integrimi i teorikes, praktikës dhe politikave te ndryshme në mënyrë qe studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit e ligjit ndërkombëtar
- Njohja e studentëve me faktin që e drejta është vetëm një pjesë e sistemit të dijes dhe ofrimi i mundësive për të përvetësuar njohuri nga disiplina të ndryshme në mënyrë që të jenë të aftë për tu përshtatur me tregun e punës
- Krijim i parakushteve për zhvillim të vazhdueshëm si rezultat i ofrimit të programeve shumë cilësore dhe konkurrente në tregun e dijes.
- Demonstrimi i anës njerëzore ne zbatimin e ligjit
- Ndërgjegjësimi i studentëve për te kontribuar për komunitetin
- Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me te mësuarit gjatë gjithë jetës ne mënyrë që ti përshtaten tregut të punës
- Zhvillim i bashkëpunimit me të gjitha institucionet që janë të kyçura në mënyrën e funksionimit të sistemit juridik të vendit duke i përfshirë këtu si organet shtetërore ashtu edhe departamenteve tjera juridike në vend.
- Përcjellja e trendëve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës ndërkombëtare.
- Përgatitje e kuadrove në fushat e ndryshme të jurisprudencës në Shqipëri, rajon dhe më gjerë etj.
- Përgatitja e kuadrove në fushën e së drejtë Evropiane

*Objektivat e Programit: Master i shkencave ne Drejtësi , profili e drejtë penale*

- Përvetësimi i koncepteve bazë juridike penale dhe përdorimi i tyre me efikasitet
- Njohja me institutet e së drejtës penale në Shqipëri dhe në Evropë si dhe dallimet që kanë sistemet e ndryshme penale ligjore
- Familjarizimi i studentëve me përgjegjësinë etike dhe profesionale
- Njohja me kushtet sociale, ekonomike, historike, politike dhe filozofike që kanë ndikuar ne sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri si dhe njohja e faktorëve dhe vlerave qe kanë ndikuar në formësimin e së drejtës penale
- Njohja me faktin që ligji ( e drejta) bazohet në sisteme te ndryshme vlerash të cilat janë vazhdimisht në ndryshim

- Integrimi i teorikes, praktikës dhe politikave te ndryshme në mënyrë qe studentët të kuptojnë mënyrën e funksionimit të ligjit
- Njohja e studentëve me faktin që e drejta është vetëm një pjesë e sistemit të dijes dhe ofrimi i mundësive për të përvetësuar njohuri nga disiplina të ndryshme në mënyrë që të jenë të aftë për tu përshtatur me tregun e punës
- Krijim i parakushteve për zhvillim të vazhdueshëm si rezultat i ofrimit të programeve shumë cilësore dhe konkurrente në tregun e dijes.
- Demonstrimi i anës njerëzore në zbatimin e ligjit
- Ndërgjegjësimi i studentëve për te kontribuar për komunitetin
- Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që ti përshtaten tregut të punës
- Zhvillim i bashkëpunimit me të gjitha institucionet që janë të kyçura në mënyrën e funksionimit të sistemit juridik të vendit duke i përfshirë këtu si organet shtetërore ashtu edhe departamenteve tjera juridike në vend.
- Dhënia e kontributit në zhvillimit e sistemit juridik penal në Republikën e Shqipërisë.
- Përcjellja e trendëve në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës penale.
- Përgatitje e kuadrove në fushat e ndryshme të jurisprudencës në Shqipëri, rajon dhe më gjerë etj.
- Përgatitja e kuadrove në fushën e së drejtës penale Evropiane

## Neni 4
## Organizimi i Studimeve

Studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Drejtësi, profile*t e Drejtë Penale* dhe *e Drejtë Ndërkombëtare* organizohen sipas sistemit me kohë të plotë.

Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor propozuar nga departamenti i Drejtësisë dhe vendim i Këshillit të Fakultetit dhe miratur me vendim të Senatit Akademik të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër).

Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* pajisen me diplomë *"Master i shkencave në Drejtësi,profili e Drejtë penale"*.

Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili *e Drejtë Ndërkombëtare* pajisen me diplomë *"Master i shkencave në Drejtësi,profili e Drejtë Ndërkombëtare"*.

**Neni 5**
**Gjuha e Studimeve**

Gjuha e studimit në programin “Master i Shkencave” në program - studimin Drejtësi, , profilet *e Drejtë Penale* dhe *e Drejtë Ndërkombëtare* janë në shqip dhe në anglisht.

**Neni 6**
**Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese**

Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese të programit është si më poshtë:
**T** - Orë Teorike
**P** - Orë Praktike
**K** - Kredite sipas Sisitemit Amerikan
**ECTS** - Kredite sipas Sistemit ECTS

**PLANI MËSIMOR**
**PROGRAMI “MASTER I SHKENCAVE” NË PROGRAM – STUDIMIN DREJTËSI, PROFILI E DREJTË PENALE**

| Semestri I | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |
| 1 | LAW | Metoda Kërkimore | Shqip | A | 56 | 94 | 4 | 6 |
| 2 | LAW | E Drejtë Penale Pjesa e Posacme | Shqip | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 3 | LAW | Procedure Penale e Avancuar me | Shqip | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | LAW | Krimi Financiar dhe Kibernetikë | Shqip | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | | Lëndë me Zgjedhje | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| **Gjithsej** | | | | | 28 | 47 | 18 | 3 |

| Semestri II | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |
| **1** | LAW | Tema Specifike ne Drejtësi | Shqip | A | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 2 | LAW | E Drejtë Penale Evropiane | Shqip | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 3 | LAW | E Drejta Ndërkombëtare Penale | Shqip | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | LAW | Kriminologji – Penologji e avancuar | Shqip | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | | Lëndë me Zgjedhje | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| **Gjithsej** | | | | | 28 | 47 | 17.5 | 3 |

| Semestri III | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LAW | Politikat Penale | Shqip | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| | LAW | Criminal | Anglisht | C | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 2 | LAW | Psychology | Shqip | C | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | | Lëndë me Zgjedhje | Anglisht | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | | Lëndë me Zgjedhje | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| Gjithsej | | | | | 28 | 47 | 17.5 | 3 |

**Semestri IV**

| Nr. | Kodi i lëndës | Lën | Gjuha | Grupi i | Leksione / | Punë Individu | Kred | ECTS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LAW | Teza | Shqip | F | 0 | 75 | | 3 |
| Gjithsej | | | | | 0 | 75 | | 3 |

**Lëndët me zgjedhje**

| Nr. | Kodi i lëndës | Lën | Gjuha | Grupi i | Leksione / | Punë Individu | Kred | ECTS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | LAW | Marrëdhëniet Juridike me Jashtë në | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 2 | LAW | International Human Rights Law | Anglisht | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 3 | LAW | Organizatat dhe institucionet | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | LAW | Viktimologji | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | LAW | Selected Topics justice and security | Anglisht | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 6 | LAW | Mjekësi Ligjore | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 7 | LAW | E drejte Penale e Krahasuar | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 8 | LAW | Criminal Justice Actors in Comparative | Anglisht | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 9 | LAW | Aktoret ne zbatimi i legjislacionit penal | Shqip | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 10 | LAW | Crime and the Media | Anglisht | D | 56 | 94 | 3. | 6 |

Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (**A**): 12 ECTS
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (**B**): 42 ECTS
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (**C**): 12 ECTS
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (**D**): 24 ECTS
Teza e Diplomës (**F**): 30 ECTS

**PLANI MËSIMOR**
**PROGRAMI “MASTER I SHKENCAVE” NË PROGRAM – STUDIMIN DREJTËSI, PROFILI E DREJTË NDËRKOMBËTARE**

| Semestri I | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |
| 1 | LAW | Research Methods | Anglish | A | 56 | 94 | 4 | 6 |
| 2 | LAW | History and Theory of International law | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 3 | LAW | European Law | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | LAW | International Organizations and | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | | Elective Course | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| **Gjithsej** | | | | | 28 | 47 | 18 | 3 |

| Semestri II | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |
| 1 | LAW | International Human Rights Law | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 2 | LAW | Public International Law | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 3 | LAW | Private International Law | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | LAW | International Investment Law | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | | Elective Course | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| **Gjithsej** | | | | | 28 | 47 | 17.5 | 3 |

| Semestri III | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |
| 1 | LAW | International Relations and Legal Settlement of | Anglish | C | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 2 | LAW | International Litigation and Arbitration | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 3 | LAW | International Intellectual Property Law and | Anglish | B | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | | Elective Course | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | | Elective Course | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| **Gjithsej** | | | | | 28 | 47 | 17.5 | 3 |

| Semestri IV | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | LAW | Thesis | Anglis | F | 0 | 75 | | 3 |
| **Gjithsej** | | | | | 0 | 75 | | 3 |

| **Lëndët me zgjedhje** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Kodi i lëndës** | **Lën** | **Gjuha** | **Grupi i** | **Leksione /** | **Punë Individu** | **Kred** | **ECTS** |
| 1 | LAW | Selected Topics in Legal Studies | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 2 | LAW | Justice, Reconciliation and Reconstruction of Post- | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 3 | LAW | The Law of Treaties | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 4 | LAW | The Law of Armed Conflicts | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 5 | LAW | International Criminal Law | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 6 | LAW | Democratic Values and International | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 7 | LAW | Selected Topics justice and security | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 8 | LAW | The Law of Diplomatic and Consular | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |
| 9 | LAW | Legal Regulation of International | Anglish | D | 56 | 94 | 3. | 6 |

Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (**A**): 6 ECTS
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (**B**): 54 ECTS
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (**C**): 6 ECTS
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (**D**): 24 ECTS
Teza e Diplomës (**F**): 30 ECTS

### Neni 7
### Kompetencat dhe objektivat formuese të veçanta të çdo veprimtarie formuese

Kompetencat dhe objektivat formues të çdo lëndë, pjesë e kurrikulës mësimore, parashikohen në syllabuset respektivë.

### Neni 8
### Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë mësimore apo veprimtarie tjetër formuese

Programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në Programin “Master i Shkencave” në program - studimin Drejtwsi, profili e Drejtw Penale:

a. Pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

| **Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë** | | **Kredite për t'u plotësuar** |
|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese | 1. Drejtësi | 0 Kredite |

| **Nga institucione të tjera të arsimit të lartë** | | **Kredite për t'u plotësuar** |
|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese | 1. Drejtësi / Juridik<br>2. Marrëdhënie Ndërkombëtare<br>3. Shkenca Politike<br>4. Programe të ngjashme studimi | 0 Kredite |

b. Me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

| **Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë** | | **Lëndët** | **Kredite për t'u plotësuar** |
|---|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar | 1. Departamenti i Shkencave të Komunikimit | 1) E Drejtë Penale Pjesa e Përgjithshme<br>2) E Drejtë Penale Pjesa e Posaçme<br>3) Procedurë Penale<br>4) Kriminalogji/Penologji<br>5) Psychology and Law | 5 ECTS<br>5 ECTS<br>6 ECTS<br>5 ECTS<br>4 ECTS |
| | **Totali** | **5 Lëndë** | **25 ECTS** |

| **Nga institucione të tjera të arsimit të lartë** | | **Lëndët** | **Kredite për t'u plotësuar** |
|---|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar | 1. Financë - Bankë<br>2. Administrim Biznesi<br>3. Menaxhim<br>4. Ekonomi<br>5. Teknologji Informacioni<br>6. Psikologji<br>7. Letërsi<br>8. Arkeologji<br>9. Shkencat Sociale | 1. E Drejtë Penale Pjesa e Përgjithshme<br>2. E Drejtë Penale Pjesa e Posaçme<br>3. Procedurë Penale<br>4. Kriminalogji/Penologji<br>5. Psychology and Law<br>6. E drejtw Publike | 5 ECTS<br>5 ECTS<br>6 ECTS<br>5 ECTS<br>4 ECTS<br>5 ECTS |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 10. Gjuhë e Huaj<br>... dhe fusha të tjera të ngjashme | | |
| | **Totali** | **5 Lëndë** | **30 ECTS** |

Programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në Programin “Master i Shkencave” në program - studimin Drejtwsi, profili e Drejtw Ndwrkombwtare:

| **Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë** | | **Kredite për t’u plotësuar** |
|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese | 1. Drejtësi | 0 Kredite |

| **Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë** | | **Kredite për t’u plotësuar** |
|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese | 1. Drejtësi | 0 Kredite |

a. Me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

| **Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë** | | **Lëndët** | **Kredite për t’u plotësuar** |
|---|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t’u plotësuar | 1. Departamenti i Shkencave të Komunikimit<br>2. Departamenti i Gjuhws dhe Letwrsisw Angleze | 1) Human Rights<br>2) International Public Law<br>3) EU Law<br>4) International Private Law<br>5) E Drejtë Administrative | 4 ECTS<br>5 ECTS<br>5 ECTS<br>5 ECTS<br>6 ECTS |
| | **Totali** | **4 Lëndë** | **25 ECTS** |
| **Nga institucione të tjera të arsimit të lartë** | | **Lëndët** | **Kredite për t’u plotësuar** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar | 1. Financë - Bankë<br>2. Administrim Biznesi<br>3. Menaxhim<br>4. Ekonomi<br>5. Teknologji Informacioni<br>6. Psikologji<br>7. Letërsi<br>8. Arkeologji<br>9. Shkencat Sociale<br>10. Gjuhë e Huaj<br>... dhe fusha të tjera të ngjashme | 1) Human Rights<br>2) International Public Law<br>3) EU Law<br>4) International Private Law<br>5) E Drejtë Administrative | 4 ECTS<br>5 ECTS<br>5 ECTS<br>5 ECTS<br>6 ECTS |
| | **Totali** | **5 Lëndë** | **25 ECTS** |

**Neni 9**

**Njohja e krediteve për njohuri të fituara më parë**

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Komiteti Shkencor mund të njohë si kredite të formimeve universitare në Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili e Drejtë Penale dhe profili e Drejtë Ndërkombëtare deri në 40 ECTS të njohurive të veprimtarive formuese të fituara më parë nga studenti, të cilat janë në përputhje me objektivat specifikë të programit

**Neni 10**

**Forma e studimit, provimet dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët**

Programi i studimit përbëhet nga 15 lëndë si dhe teza e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programeve të studimit të Ciklit të Dytë.

1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve
1 semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve
1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
1 orë mësimore = 60 minuta
Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune.
Programi organizohet në dy vite akademikë, i ndarë në katër semestra
Një vit akademik ka 60 ECTS

Procesi mësimor përbëhet nga leksionet dhe seminaret, të cilat kryesisht jepen në mënyrë të integruar, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor si dhe sylabuset përkatëse të lëndëve.

Vlerësimi sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS) nga pikëpamja akademike për leksionet/seminaret, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse orë të zhvilluar në auditor.

Vlera e krediteve sipas sistemit amerikan të vlerësimit të një lëndë përbëhet nga shuma e të gjithë orëve javore të leksioneve teorikë javorë dhe sa gjysma e orëve javore të aplikimeve, labotatorëve, projekteve dhe punës në atelje.

Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestralë; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve. Me propozim të drejtuesit të programit përkatës dhe vendim të Komitetit Shkencor, studentit i jepet e drejta të hyjë në provim, nëse nuk ka hyrë gjatë vitit për shkaqe të arsyeshme dhe të dokumentuara, brenda shtatë ditëve nga dita e provimit.

**Neni 11**
**Frekuentimi**

Studenti në programin e studimit ka detyrimin të ndjekë të mbi 70% të aktiviteteve mësimore - kërkimore të zhvilluara në auditor të lëndëve teorike dhe të aktiviteteve mësimore-kërkimore. Studentët të cilët tejkalojnë këtë normë duhet ta rimarrin përsëri atë lëndë me të gjitha detyrimet përkatëse.

Plotësimi apo jo i kushteve në lidhje me pjesëmarrjen, i paraqitet sekretarit të departamentit nga ana e pedagogut të lëndës çdo muaj dhe kontrollohet nga përgjegjësi i Departamentit

**Neni 12**
**Transferimi i studentëve**

Kuotat për transferimet në Programin “Master i Shkencave” në programin e studimit Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* dhe profili *e Drejtë Ndërkombëtare* përcaktohen nga Komiteti Shkencor dhe miratohen nga Këshilli i Administrimit të Fakultetit, duke u bazuar në parimet e vendosura nga ky Këshill.

Studentët të cilët studiojnë në programe të Ciklit të Dytë ose ekuivalentë me to, brenda dhe jashtë Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë – BEDER”, mund të aplikojnë për t’u transferuar në programet e Ciklit të Dytë të në departamentin e Drejtësisë, “Master i Shkencave” në Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* dhe profili *e Drejtë Ndërkombëtare*

Studentët që kanë kryer një semestër në një program të studimit të Ciklit të Dytë, mund të aplikojnë pranë sekretarisë mësimore brenda afateve të caktuara në kalendarin akademik, për t'u transferuar në këtë program, në përputhje me parimet e vendosura nga ana e Senatit.

Studenti që dëshiron të transferohet në programin "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* dhe profili *e Drejtë Ndërkombëtare*, për programet e studimit brenda Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë – BEDER" duhet që përveç plotësimit të të gjitha kritereve të përcaktuara për pranimin në programet e Ciklit të Dytë, t'i paraqesë një kërkesë me shkrim Komitetit Shkencor të këtij programi, ku të parashtrojë kërkesën për njohjen e krediteve të fituara në programin pararendës.

Studenti që dëshiron të transferohet në programin "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* dhe profili *e Drejtë Ndërkombëtare*, nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, duhet që përveç plotësimit të kritereve të mësipërme, bashkë me kërkesën e aplikimit për transferim, të paraqesë një dokument zyrtar me notat përkatëse dhe brendësinë e lëndëve të zhvilluara.

Pas dorëzimit të dokumentacionit të mësipërm, Komiteti Shkencor i programit shqyrton kërkesën për njohjen e krediteve dhe bën vlerësimin e përputhshmërisë së programeve mësimore në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesi dhe merr vendimin përkatës.

Studentëve të cilët janë transferuar në këtë program u jepet diplomë me kushtin që të kenë kryer të paktën një semestër në Shkollën e Lartë "Hëna e plotë – BEDER".

## Neni 13
## Numri i studentëve

Numri minimal i studentëve në Programin "Master i Shkencave" në Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* dhe profili *e Drejtë Ndërkombëtare* është gjashtë dhe ai maksimal është pesëdhjetë.

## Neni 14
## Kushtet e pranimit

Për t`u pranuar në programin e studimeve "Master i Shkencave" në në Drejtësi, profili *e Drejtë Penale* dhe profili *e Drejtë Ndërkombëtare*, çdo shtetas shqiptar apo i huaj që aplikon nevojitet të ketë përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit Bachelor. Preferohen ata studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit Bachelor në programin e studimit Drejtësi ose të ngjashëm me këtë program.

## Neni 15
## Vlerësimi i stafit akademik

Vlerësimi i titujve të stafit akademik është kompetencë e departamentit të Drejtësisë dhe bëhet me procedura publike.

**Neni 16**
**Udhëheqja e Tezës**

Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.

Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.

Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të përparuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

**Neni 15**
**Niveli i Gjuhës Angleze**

Studentët e programit të studimit në fjalë japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të Ciklit të Dytë niveli i gjuhës angleze është C1, kjo sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve.

## KREU 3
## DISPOZITA TË FUNDIT

**Neni 15**
**Zbatimi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj në Këshillin e Lartë të Shkollës së Lartë.

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Rektori

| Njësia përpiluese | Njësia | Njësia miratuese |
|---|---|---|
| Sen | Këshilli i vlerësimit akademik dhe | Këshilli i lartë |